



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/89

Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Performancën Energjetike në Ndërtesa.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/89

Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ndihmën Shtetërore.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/89


Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Obligimet Materiale, Llojet e të Mirave Materiale, Mënyra e Përdorimit dhe Kompensimit të tyre.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/89

Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, nenit 29 të Rregullores 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e klasifikimit të vendeve të punës të Nëpunësve Civilë

1. Aprovohet klasifikimi i vendeve të punës. (shtojca I e këtij vendimi)
2. Obligohen institucionet të vendosin gradat e miratuara nga pika 1. e këtij vendimi, për çdo nëpunës civil, dhe të bëjnë plotësim ndryshimin e akt emërimeve të tyre.
3. Për të gjitha proceset që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore përfshirë edhe procesin e klasifikimit të vendeve të punës, obligohen institucionet të përdorin sistemin informativ (SIMBNJ),
4. Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike të propozojë vlerën e koeficientit për zbatimin e klasifikimit të vendeve të punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në harmoni me mundësitë buxhetore, ku në pagën bazë duhet të përfshihet edhe shtesa prej 30 euro,
5. Ministria e Administratës Publike të dërgojë udhëzime për institucionet me qëllim të zbatimit të procesit të klasifikimit të vendeve të punës.
6. Autorizohet Komisioni MAP-MF për klasifikim, që vendet e punës të cilat nuk janë dërguar për klasifikim nga institucionet përkatëse dhe të cilat janë të njëjta ose të ngjashme me vendet e punës të klasifikuara, t'i klasifikojë në grada ekuivalente me pozitat e klasifikuara sipas shtojcës I të këtij vendimi, në afat prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
7. Procesi i klasifikimit të Nëpunësve Civil fillon të zbatohet nga 1 shtatori i vitit 2016.
8. Obligohen të gjitha institucionet e ndikuara për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/89

Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi për Përzgjedhjen e Modelit të Përzier për Financimin Publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ-të), i cili do të adresojë nevojën për krijimin e një kornize transparente për shpërndarjen e fondeve publike për Organizatat e Shoqërisë Civile-OJQ-të, dhe që është përcaktuar si një nga qëllimet kyçe të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017.
2. Propozimi për Modelin e Përzier për Financimin Publik të Organizatave Jo Qeveritare, që është paraqitur në Memorandum, bashkë me anekset që i janë bashkëngjitur, adreson çështjet në përputhje me Objektivin e tretë të Strategjisë.
3. Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Financave obligohen për hartimin e Rregullores mbi Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Shpërndarjen e Fondeve, bashkë me Metodologjinë e Monitorimit dhe Raportimit për Financimin e Përgjithshëm Publik të Organizatave të Shoqërisë Civile.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Ministria e Financave.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/89

Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar të kufirit IBM: Pika Kufitare Kapi, Zona Kadastrale Sfirçë, Komuna e Kamenicës, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokollit 1885/16 datë 22.04.2016.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike, kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit, të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/89

Datë: 25.05.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 17 të Udhëzimit Administrativ QRK - Nr. 01/2015 për Përbërjen, Detyrat, Përgjegjësitë dhe Procedurën e Vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave për të Huajt, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/26 i datës 4 maj 2015 për Komisionin e Ankesave për të Huajt, si në vijim: "pika 1.2. e Vendimit riformulohet dhe Burbuqe Spahija-Kërveshi zëvendësohet nga Isuf Jahmurataj zëvendës kryesues MD, pika 1.4. e Vendimit riformulohet dhe Zenel Gashi zëvendësohet nga Imer Berisha-anëtar MPJ, dhe pika 1.6 e Vendimit riformulohet dhe Rexhep Bllaca zëvendësohet nga Valon Berisha-anëtar MPJ".
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë